



GRENELLI: TURP QË THAÇI ENDE MBAHET NË BURG!

FAQE 4-5



Ish-i dërguari i presidentit amerikan Donald Trump për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka rikujtuar se arrestimi i ish-presi-

dentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ndodhi pikërisht në kohën kur ShBA-ja po përpiqej të arrinte një marrëveshje në mes të Kosovës dhe

Serbisë. "Është e turpshme që ai ende gjendet në burg. Është një mashtrim. Haga është e rrënuar", ka shkruar Grenelli në platformën "X"

PDK-ja BËN PUBLIKE KANDIDATURAT PËR KRYETARË KOMUNASH, LLADROVCI ZËVENDËSOHET ME PETRIT HAJDARIN NË DRENAS

F. 4



GUCATI: GJYKATA SPECIALE PO PËRPIQET TA BARAZOJË LUFTËN E UÇK-SË ME ÇETNIKËT SERBË

F. 6



AKTUALE



OBSH: KEQUSHOYERJA NË GAZË PO PREK 'NIVELE ALARMANTE'

F. 2

OSMANI KËRKON NDALJEN E KATASTROFËS HUMANITARE NË GAZË

F. 5

A PO E DËMTON KOTORIN STATUSI I UNESCO-S? NË MAL TË ZI S'PAJTOHEN DOT

F. 7

EKONOMI



AUV-I SHFUQIZON NDALESËN E IMPORTIT TË KAFSHËVE TË GJALLA NGA HUNGARIA ME PËRJASHTIM TË DY ZONAVE

F. 8

SUPREMJA SHFUQIZON NENE TË CAKTUARA TË UDHËZIMIT ADMINISTRATIV PËR PAGESAT DIREKTE NË BUJQËSI

F. 8

SPORT



SHKËLZEN LUSHTAKU LARGOHET NGA DRENICA PAS 23 VJETËSH

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OBSH: Kequshqyerja në Gazë po prek ‘nivele alarmante’

GAZA, 28 KORRIK - Niveli i kequshqyerjes në Rripin e Gazës ka arritur në “nivele alarmante”, ka paralajmëruar Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), dhe që “bllokada e qëllimshme” e ndihmës ka qenë krejtësisht e parandalueshme, por që ka kushtuar me shumë jetë. “Kequshqyrja është në trajektore të rrezikshme në Rripin e Gazës edhe për shkak të rritjes së numrit të vdekjeve në korrik”, ka thënë OBSH-ja në një deklaratë. Prej 74 vdekjeve të regjistruara më 2025 si pasojë e kequshqyerjes, 63 janë raportuar në korrik, përfshirë 24 fëmijë nën pesë vjeç, një tjetër mbi pesë vjeç

dhe 38 të rritur. “Shumica e këtyre njerëzve janë shpallur të vdekur sapo kanë arritur në qendrat shëndetësore, ose kanë vdekur pas një kohe të shkurtër, dhe trupat e tyre kanë treguar shenja të rënda të lodhjes”, ka thënë kjo agjenci e Kombeve të Bashkuara. “Krizë vazhdon të jetë krejtësisht e parandalueshme. Bllokimi i qëllimshëm dhe vonesa e madhe e ushqimit dhe ndihmës shëndetësore e humanitare ka kushtuar me shumë jetë”. Izraeli ka bërë me dije të dielën për një “pauzë të kufizuar taktike” në operacionet ushtarake për t’i lejuar Kombet e Bashkuara dhe agjencitë për ndihmë që ta

luftojnë krizën e thellë të urisë. Ndërkohë, Jordania ka thënë të dielën se ka punuar me Emiratet e Bashkuara Arabe dhe i kanë gjuajtur nga ajri 25 tonë ndihma në Gazë. Të mërkurën, shefi i OBSH-së, Tedros Adhanom Ghebreyesus, e ka përshkruar situatën si “uri masive të shkaktuar nga dora e njeriut”. Izraeli e ka nisur fushatën ushtarake në Gazë në përgjigje të sulmit të kryer nga Hamasi në jug të Izraelit më 7 tetor 2023 si pasojë e të cilit janë vrarë 1 200 njerëz dhe janë marrë peng rreth 240 të tjerë. Hamasi është i shpallur grup



terrorist nga Shtetet e Bashkuara dhe fuqi të tjera. Sipas autoriteteve shëndetësore palestineze, mbi 59 000 palestinezë janë vrarë në Gazë që prej atëherë.

Autoritetet: Shpërthimi i ujërave të zeza nxori trenin nga binarët në Gjermani

BERLIN, 28 KORRIK - Dalja e një treni nga binarët në jugperëndim të Gjermanisë, që ka rezultuar me tre persona të vdekur të dielën, mund të jetë shkaktuar nga një shpërthimi i ujërave të zeza, kanë thënë zyrtarë policorë dhe prokurorë të hënën. “Besohet se shiu i rrëmbyeshëm në zonën e aksidentit e ka shkaktuar derdhjen e një boshti ujërash të zeza”, ka thënë policia e Ulmit dhe prokurorët përmes një komunikate të përbashkët. “Uji ka nxitur rrëshqitjen e dheut



pranë binarëve dhe kjo ka rezultuar me daljen e trenit jashtë tyre”, është thënë në komunikatë. Rreth 100 pasagjerë kanë qenë në tren kur ka ndodhur aksidenti në qytezën Ridlingen në zonën e Shtutgartit. Sipas shërbimeve të motit, në kohën e aksidentit janë regjistruar disa stuhi në atë rajon. Autoritetet kanë thënë se tre persona kanë vdekur, përfshirë shoferin dhe një pjesëtar të stafit. Të paktën 41 persona janë lënduar dhe disa prej tyre janë në

gjendje të rëndë. Trafiku është ende i pezulluar në zonën e aksidentit, sepse aty kanë nisur hetimet dhe pastrimi i zonës. Sipas autoriteteve, hetimet fillestare nuk tregojnë për ndonjë ndërhyrje të paligjshme. Konsullata e Republikës së Kosovës në Shtutgart ka bërë me dije në “Facebook” se është në kontakt me autoritetet gjermane dhe që deri më tani nuk ka asnjë konfirmim që ndonjë shtetas i Kosovës është në mesin e viktimave apo të lënduarve.

“Google” dështoi t’i paralajmëronte 10 milionë turq për tërmetin e vitit 2023

ANKARA, 28 KORRIK - Gjiganti “Google” e ka pranuar se sistemi i tij i paralajmërimit për tërmete ka dështuar t’i njoftojë njerëzit në kohën e tërmetit vdekjeprurës që ka ndodhur në Turqi më 2023. Dhjetë milionë njerëzve brenda 157 kilometrave të epiqendrës do të mund t’u dërgohej alarmi i nivelit më të lartë - pra një paralajmërim 35-sekondësh për të gjetur diku strehim. Si përfundim, vetëm 469

persona kanë pranuar këso paralajmërim për tërmetin 7.8 shkallësh të Rihterit. “Google” i ka thënë transmetuesit britanik BBC se gjysmë milioni njerëz kanë pranuar paralajmërim të nivelit më të ulët të cilat janë të dizajnuara për “shkundje të lehta”. Paraprakisht, ky gjigant teknologjik kishte deklaruar se sistemi ka performuar “mirë”. Sistemi funksionon në pajisjet Android të cilat i përdorin mbi 70 për qind e banorëve të

Turqisë. Më shumë se 55 000 njerëz kanë vdekur si pasojë e dy tërmeteve të mëdha që patën goditur juglindjen e Turqisë më 6 shkurt 2023, ndërsa mbi 100 000 janë plagosur. Shumica e banorëve kanë qenë në gjumë nëpër banesat e tyre në kohën kur kanë nisur dridhjet. Sistemi paralajmërues i “Google”-it ka qenë funksional në ditën e tërmetit, mirëpo e ka nënvlerësuar fuqinë e tërmeteve.



Ambasadori i ri i Serbisë në ShBA ia dorëzon Trumpit letrat kredenciale dhe e fton për vizitë në Beograd



UASHINGTON, 28 KORRIK - Ambasadori i ri i Serbisë në Shtetet e Bashkuara, Dragan Shutanovac, ia dorëzoi presidentit amerikan Donald Trump letrat kredenciale më 28 korrik në Shtëpinë e Bardhë dhe e ftoi atë për një vizitë në Beograd. Në rrjetet sociale, Shutanovac tha se gjatë takimit me Trumpin

është diskutuar për mundësinë e forcimit të marrëdhënieve mes dy vendeve, përfshirë bashkëpunimin në fusha si: energjia, inteligjenca artificiale, infrastruktura dhe mbrojtja. “Në një atmosferë miqësore dhe konstruktive, biseduam për marrëdhëniet mes Serbisë dhe Shteteve të Bashkuara. Ia kujtova

presidentit Trump se asnjë president amerikan nuk e ka vizituar Serbinë që nga viti 1980 - dhe e ftova ta ndryshojë këtë”, shkroi Shutanovac. Sipas tij, mesazhi i këtij takimi ishte i qartë: “Ta bëjmë partneritetin strategjik serbo-amerikan madhështor sërish” - një shprehje që i referohet sloganit të njohur të

fushatës së Trumpit. Ambasadori Shutanovac theksoi se Serbia dhe ShBA-ja po shqyrtojnë mundësi bashkëpunimi në disa drejtime me rëndësi strategjike, përfshirë energjinë, inteligjencën artificiale, projektet infrastrukturore dhe fushën e mbrojtjes.

GRENELLI: TURP QË THAÇI ENDE MBAHET NË BURG!

Ish-i dërguari i presidentit amerikan Donald Trump për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka rikujtuar se arrestimi i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ndodhi pikërisht në kohën kur ShBA-ja po përpiqej të arrinte një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë. “Është e turpshme që ai ende gjendet në burg. Është një mashtrim. Haga është e rrënuar”, ka shkruar Grenelli në platformën “X”

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 KORRIK - Ish-i dërguari i presidentit amerikan Donald Trump për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka rikujtuar edhe një herë se ishte prokurori Jack Smith ai që urdhëroi arrestimin e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi. Në rrjetin social “X”, Grenelli ka theksuar se arrestimi i Thaçit ndodhi në vitin 2020, pikërisht në kohën kur administrata Trump po angazhohej intensivisht për të arritur një marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. “Jack Smith (po, ai) e arrestoi Hashim Thaçin në vitin 2020, në kohën kur Donald Trumpi ishte duke punuar për marrëveshjen Kosovë - Serbi. Është e turpshme që ai ende gjendet në burg. Është një mashtrim. Haga është e rrënuar”, ka shkruar Grenell.

Ish-përfaqësuesi politik i UÇK-së në Zvicër, Bardhyl Mahmuti, ka thënë se pajtohet me deklaratën e Grenellit. “Jam plotësisht dakord me konstatimin e z. Richard Grenell se legjitimiteti i gjykatës në Hagë është rrënuar tërësisht, mirëpo pa ndërhyrje të fuqishme politike për ta shpërbërë atë që u krijua për motive politike dhe ideologjike,



kjo rrënojë do të vazhdojë të mbajë padrejtësisht nën gërmadhat e saj njerëz të pafajshëm”, ka shkruar Mahmuti në “Facebook”. Fondacionit për Mbrojtjen Juridike të Thaçit javën e kaluar ka kërkuar ndërhyrje urgjente nga qeveria dhe Ministria e

Drejtësisë për ndarje të pagesave shtesë për mbrojtjen e ish-presidentit. Sipas tyre, kufizimet aktuale financiare mund të kenë pasoja serioze në ecurinë e mbrojtjes dhe në perceptimin institucional të luftës çlirimtare. Thaçi ndodhet në Qendrën e

Paraburgimit në Hagë që nga nëntori i vitit 2020.

Ai dha dorëheqje nga pozita e presidentit të Kosovës më 5 nëntor 2020. Po atë ditë, së bashku me ish-kryetarin e Kuvendit, Kadri Veseli, dhe ish-kryetarin e grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje,

Rexhep Selimi, udhëtuan me aeroplan drejt Hagës, ku më pas u transferuan në qendrën e paraburgimit.

Thaçi po gjykohej për të ashtuquajtura krime lufte si dhe së fundi i është ngritur edhe një aktakuzë kundër administrimit të drejtësisë.

ÇFARË TASH ME KUVENDIN, CILA ËSHTË ZGJIDHJA E NGËRÇIT POLITIK?

PRISHTINË, 28 KORRIK - Me të hyrë në sekondën e parë të kësaj të diele, 120 deputetët e Kosovës nuk kanë të drejtë të bëjnë asnjë veprim apo vendim për konstituimin e Kuvendit të Kosovës. Ata, deri më 8 gusht, derisa të përfundojë masa e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese, mund t'i kryejnë pushimet dhe ta presin pagën e radhës pa bërë asgjë.

Por, edhe Gjykata Kushtetuese në lidhje me zgjidhjen e këtij ngërçi politik duket se duart i ka goxha të lidhura, të paktën kështu thotë Melos Kolshi nga IKD. “Sa iu përket zgjidhjeve, mund të themi që ka shumë zgjidhje, mirëpo ka edhe shumë kufizime. Në të njëjtën mund të themi që zgjedhjet e reja mund të jenë si një opsion, pasi Kuvendi nuk është konstituuar brenda afatit kushtetues, edhe ne e kemi një pikë në aktgjykimin e vitit 2014, në të cilën thuhet se dështimi i zgjedhjes së kryetarit na çon drejt zgjedhjeve të reja”, ka deklaruar Kolshi, raporton



“RTVDukagjini”.

Ai thotë që vendi mund të shkojë në zgjedhje përmes presidentes, por Kushtetuesja nuk mund ta marrë mandatin e

deputetëve. “Kjo situatë e tillë nuk do t'i ngjante një praktike të mirë, pasi që marrja e mandatit të deputetëve caktohet me Kushtetutë, dhe

janë kushtet e parapara që mund të caktohen nga deputetët”, ka theksuar Kolshi. Ndërkaq analisti politik Artan Muhaxheri thotë se humbjet që

ka Kosova në këtë bllokadë janë aq të mëdha sa vështirë mund të rikuperohen. “Faktikisht ne vështirë se mund ta kemi idenë se sa kemi humbur me këtë bllokadë në të gjitha aspektet: në aspektin politik, në aspektin ekonomik, në aspektin e brendshëm, në aspektin e jashtëm. Pra, Kosova është duke humbur miq, Kosova është duke humbur imazh, Kosova duhet të punojë shumë në mënyrë që të kthehet në pikën e 9 shkurtit, prej kur ka filluar kjo sagë”, ka deklaruar Muhaxheri. Sipas tij, edhe qëndrimet e faktorit ndërkombëtar po tregojnë mjaftueshëm. “Bashkësia ndërkombëtare, veçanërisht BE-ja, nuk e konsideron qeverinë aktuale në detyrë qeveri legjitime dhe fuqiplotë, prandaj e kemi parë se edhe gjatë vizitave nuk e kanë trajtuar as Kurtin si kryeministër që ta vizitojnë në zyrë”, ka theksuar ai. Kuvendi nuk është konstituuar në 54 tentime.



PDK-ja BËN PUBLIKE KANDIDATURAT PËR KRYETARË KOMUNASH, LLADROVCI ZËVENDËSOHET ME PETRIT HAJDARIN NË DRENAS

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 KORRIK - Kryesia e Partisë Demokratike të Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës në të cilën është diskutuar për zhvillimet e fundit politike në vend, për përgatitjet për zgjedhjet lokale të 12 tetorit si dhe është miratuar lista përfundimtare e kandidatëve për kryetarë të komunave.

Pas përfundimit të afatit 30-ditor të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese për konstituimin e Kuvendit, PDK vlerëson se, për fat të keq, Kosova tashmë po ecën në një territor të panjohur kushtetues, institucional, shtetëror dhe shoqëror. Në këtë terren të mjegullt Kosova nuk është vetëm e humbur në koordinatat e brendshme, por edhe gjithnjë e më e paorientuar në hartën ndërkombëtare. PDK-ja do ta presë aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese për lëndën e dërguar nga deputetët tanë, me shpresë se do të qartësohet ruga

për themelimin e institucioneve të reja dhe legjitime.

Sa iu përket zgjedhjeve lokale të 12 tetorit, Partia Demokratike e Kosovës hyn në këtë proces e mobilizuar fuqishëm dhe me synimin jo vetëm për t'i rifituar komunat ku aktualisht qeveris me përgjegjësi dhe rezultate konkrete, por edhe për të fituar në komuna të tjera të rëndësishme, aty ku qytetarët kërkojnë një vizion të ri dhe një qeverisje më të mirë për të ardhmen e tyre.

Në frymën e këtij angazhimi, Kryesia e PDK-së, në bazë të nenit 48, paragrafi 13 i Statutit të Partisë, ka votuar dhe miratuar sot listën përfundimtare të 31 kandidatëve për kryetarë të komunave.

Për degët e PDK-së në Deçan, Drenas, Gjiilan, Istog, Junik, Kamenicë, Malishevë, Obiliq, Podujevë, Rahovec dhe Suharekë, të cilat kanë organe të emëruara apo që janë të përcaktuara sipas vendimit të Këshillit Drejtues të PDK-së të datës 28 mars 2022, është zbatuar Rregullorja për

Përcaktimin e Kriteve dhe Mënyrës së Përzgjedhjes së Kandidatëve për Kryetarë Komunash, e miratuar nga Këshilli Drejtues i PDK-së. Rrjedhimisht, për disa nga këto degë, të cilat kanë pasur më shumë se një kandidat për kryetar të komunës, është zhvilluar procedura e votimit të fshehtë, sipas kriteve të përcaktuara në rregullore dhe në statut.

Kandidaturat që janë miratuar nga Kryesia e Partisë Demokratike të Kosovës janë si vijon:

1. Prishtinë, Uran Ismaili
2. Ferizaj, Agim Aliu
3. Prizren, Shaqir Totaj
4. Mitrovicë, Arian Tahiri
5. Vushtrri, Ferit Idrizi
6. Skenderaj, Sami Lushtaku
7. Drenas, Petrit Hajdari
8. Kaçanik, Sabedin Vishi

9. Hani i Elezit, Mehmet Ballazhi
10. Gjiilan, Riad Rashiti
11. Pejë, Arta Nallbani
12. Gjakovë, Ervin Shabani
13. Klinë, Sokol Bashota
14. Lipjan, Shukri Buja
15. Shtëmë, Përparim Ramusa
16. Dragash, Shaban Shabani
17. Malishevë, Gëzim Krasniqi
18. Rahovec, Edon Cana
19. Suharekë, Dardan Berisha
20. Podujevë, Isak Shabani
21. Fushë Kosovë, Rrahim Tërri
22. Kamenicë, Jona Arifi
23. Viti, Bekim Azizi
24. Istog, Ali Nimanaj
25. Deçan, Korab Mushkolaj
26. Zubin Potok, Izmir Zeqiri
27. Zvečan, Ilir Peci
28. Mitrovicë e Veriut, Flutura Hamza
29. Leposaviq, Shaqir Hetemi
30. Shtërpçë, Garip Sahiti
31. Novobërdë, Selatin Nuhio

Partia Demokratike e Kosovës shpreh mirënjohje të veçantë për kontributin e katër kryetarëve aktualë të komunave: Bedri

Hamza (Mitrovicë), Ramiz Lladrovci (Drenas), Fadil Nura (Skenderaj) dhe Besim Ilazi (Kaçanik), të cilët nuk janë kandidatë në këto zgjedhje, por që gjatë mandatit të tyre kanë ofruar një qeverisje efikase për qytetarët dhe një përfaqësim dinjitoz të vlerave të PDK-së.

Me miratimin e kësaj liste përmbyllet zyrtarisht procesi i kandidimit për kryetarë të komunave.

PDK-ja do të garojë në katër komuna të tjera, Obiliq, Junik, Kllokot dhe Mamushë, vetëm me listë të kandidatëve për Kuvendin Komunal. Ndërkaq, në Graçanicë do të garojë në një listë të përbashkët me të gjitha partitë e tjera shqiptare. "Ne besojmë fuqishëm se në zgjedhjet e 12 tetorit do të fitojë sërish vizioni ynë për një qeverisje të ndershme, efikase dhe në shërbim të çdo qytetari, vizion që do të reflektohet në çdo komunë ku PDK do ta marrë përgjegjësinë e qeverisjes", është thënë në njoftimin e PDK-së.

Lladrovci falënderon qytetarët për mijëra mesazhe dhe telefonata përkrahëse

DRENAS, 28 KORRIK - Ramiz Lladrovci ka falënderuar qytetarët, miqtë, dashamirët dhe përkrahësit për mijëra mesazhe dhe telefonata përkrahëse që ka marrë pas vendimit të Kryesisë së PDK-së rreth kandidaturës së tij. "Dua të

shpreh mirënjohjen time të thellë dhe konsideratën për të gjithë, në pamundësi veç e veç t'ju përgjigjem ndaj mesazheve në të gjitha rrjetet sociale dhe telefonatat. Në veçanti shpreh keqardhje për mosmundësi t'i përgjigjem mediave të cilat kanë

ndjekur punën time ndër vite. E kam ditur se puna ime me përkushtim, sinqeriteti dhe vendosmëria për qeverisjen shembullore dhe me duar të pastra, pa iu nënshtruar keqbërësve e merr përkrahjen dhe simpatinë jo vetëm nga

qytetarët e komunës së Drenasit por gjithandej trojeve shqiptare. Faleminderit, bashkë, vazhdojmë, +4!", ka shkruar Lladrovci në "Facebook". Kryesia e PDK-së ka votuar kandidaturën e Petrit Hajdarit për kryetar të Drenasit.



BIE NUMRI I ZJARREVE NË KOSOVË

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 KORRIK - Agjencia e Menaxhimit Emergjent ka bërë me dije se shkak i temperaturave të larta dhe erërave të forta, në disa zona të Kosovës janë përhapur zjarre. Agjencia njoftoi se një zjarrfikës është lënduar në Ferizaj, gjatë intervenimit për shuarjen e zjarreve. Sipas të dhënave të pranuar në Qendrën Operative të Agjencisë, gjatë gjashtë orëve të fundit janë raportuar gjithsej 80 vatra zjarri. Prej tyre, 35 janë ende aktive, ndërsa 45 janë lokalizuar. Situata më e vështirësuar paraqitet në komunën e Klinës, konkretisht në fshatrat Siqevë dhe Resnikë. Fatmirësisht, deri

më tani nuk është raportuar për viktima apo persona të lënduar. Situata po menaxhohet nga AME dhe Njësitë e Zjarrfikësve me të gjitha kapacitetet në dispozicion. “U bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve të tregojnë kujdes të shtuar, të shmangin çdo veprim që mund të shkaktojë zjarr dhe të raportojnë menjëherë çdo vatër të dyshimtë në numrat emergjentë 112, 193 ose 192. Agjencia, në bashkëpunim me Njësitë e Zjarrfikësve dhe Policinë e Kosovës, mbetet në gatishmëri të plotë. Agjencia falënderon zjarrfikësit për përkushtimin e tyre të palodhshëm, Policinë e Kosovës dhe KFOR-in për mbështetjen, si dhe qytetarët për bashkëpunimin”, ka njoftuar

Agjencia e Menaxhimit Emergjent. Edhe pse Agjencia e Menaxhimit Emergjent nuk ka treguar se në cilat zona janë përhapur zjarre, kryetari i komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije për zjarre në disa fshatra të kësaj komune. “Kushdo që ka mundësi e që ka pajisje për shuarje të zjarrit, le të ndihmoj në hapësirën Dubravë - Sallagrazhdë - Mushtisht”, shkroi në “Facebook”, ku publikoi një video. Për zjarret pati reaguar edhe presidentja Vjosa Osmani, e cila ka theksuar se institucionet e Republikës së Kosovës janë të mobilizuara për ta ofruar ndihmën e nevojshme. “Komuna të shumta të vendit

tonë po përballen me vatra të shumta zjarri që po shkaktojnë dëme të konsiderueshme materiale dhe mjedisore. Situata është sfiduese dhe kërkon reagim të koordinuar dhe të menjëhershëm nga të gjitha nivelet. Në këto momente, shpreh solidaritetin tim të plotë me të gjithë qytetarët e prekur, me fermerët që po humbin frytet e mundit dhe djersës së tyre, si dhe me ekipet emergjente që po punojnë pa u ndalur për t’i vënë nën kontroll këto zjarre. Mirënjohje të thellë për zjarrfikësit tanë, për punonjësit e emergjencës dhe për të gjithë vullnetarët që me guxim dhe përkushtim janë në vijën e parë të përballjes me flakët. Institucionet e Republikës së

Kosovës janë të mobilizuara për të ofruar ndihmën e nevojshme. FSK-ja është në gjendje gatishmërie të plotë dhe e gatshme të ofrojë mbështetje të menjëhershme në rast se kërkohet nga autoritetet komunale apo ato qendrore për emergjencat civile. U bëj thirrje të gjithë qytetarëve që të tregojnë kujdes të shtuar, të shmangin çdo veprim që mund të shkaktojë zjarr, dhe të raportojnë menjëherë çdo vatër të dyshimtë tek autoritetet përkatëse. Vetëm me përgjegjësi kolektive mund ta parandalojmë përhapjen e mëtejshme të zjarreve. Mbështetja dhe bashkëpunimi i secilit prej nesh është thelbësor për ta përballuar këtë situatë”, ka thënë Osmani.



OSMANI KËRKON NDALJEN E KATASTROFËS HUMANITARE NË GAZË



PRISHTINË, 28 KORRIK - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka shprehur shqetësimin për katastrofën humanitare në Gaza dhe ndikimin shkatërrues që po ka konflikti mbi civilët, veçanërisht fëmijët. Osmani në platformën “X” ka shkruar se fëmijët nuk fillojnë kurrë luftëra, por janë ata që vuajnë më shumë dhe mbajnë pasojat më të mëdha të çdo konflikti. “Katastrofa humanitare në Gaza dhe vuajtjet e civilëve të pafajshëm, veçanërisht fëmijëve, është zemërthyes dhe duhet të marrë fund. Çdo fëmijë, çdo familje, pavarësisht kombësisë apo fesë, është e çmuar dhe duhet të mbrohet”, ka shkruar Osmani. Presidentja vuri në dukje se çdo jetë njerëzore është e çmuar pavarësisht kombësisë apo fesë, dhe se mbrojtja e fëmijëve dhe familjeve duhet të jetë prioritet për të gjithë aktorët ndërkombëtarë. Ajo shprehu mbështetjen e plotë të Kosovës

për përpjekjet për armëpushim, të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara, Katari dhe Egjipti, si dhe për lirinë e menjëhershëm të të gjitha pengjeve. “Ndërkohë, sigurimi i aksesit në ushqim, ujë dhe ilaçe për më të prekshtit duhet të mbetet një përparësi kryesore për të lehtësuar vuajtjet e shkaktuara nga lufta midis të pafajshmëve”, theksoi Osmani. Ndër të tjera, ajo ka shkruar: “Kosova vazhdon të mbështesë përpjekjet ndërkombëtare që synojnë arritjen e një të ardhmeje të drejtë, të qëndrueshme dhe paqësore, ku si izraelitët ashtu edhe palestinezët mund të jetojnë me dinjitet, siguri dhe respekt të ndërsjellë, me një angazhim të përbashkët për mbrojtjen e jetës njerëzore. Derisa të realizohet kjo e ardhme, duhet të bëhet çdo përpjekje për të parandaluar humbjen e mëtejshme të jetëve të pafajshme dhe për të lehtësuar vuajtjet e të gjithë njerëzve”.

PRESIDENTJA DHE KUSHTETUTA PËRBALLË NJË KUVENDI TË PAKONSTITUUAR

Shkruan: Prof.
Dr. Fejzulla BERISHA

I. Konteksti kushtetues: Fundi i afatit dhe fillimi i krizës institucionale

Më 26 korrik 2025 përfundoi afati kushtetues për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, i dalë nga zgjedhjet e parakohshme të 9 shkurtit. Moskonstituimi i Kuvendit brenda afatit 60-ditor të paraparë në nenin 66 të Kushtetutës nuk përfaqëson thjesht një krizë politike - ai përbën një boshllëk serioz kushtetues, i cili e paralizon funksionimin demokratik dhe institucional të shtetit. Ky realitet imponon nevojën për veprime urgjente, të mençura, të përgjegjshme dhe plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

II. Çfarë ndodhi konkretisht?

Për më shumë se katër muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve, deputetët e Kuvendit të ri nuk arritën ta përmbushin aktin themeltar të konstituimit - zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit. Seanca e fundit, e mbajtur më 26 korrik 2025, përfundoi pa ndonjë vendim konkret, ndërkohë që disa deputetë tentuan ta lënë të hapur idenë se ajo seancë mund të "vazhdohet" në një datë të mëvonshme. Ky është një keqinterpretim i rëndë dhe krejtësisht i papranueshëm i normave kushtetuese. As Kushtetuta, as Ligji për Kuvendin nuk njohin një të drejtë për "vazhdim të seancës konstituive" përtej afatit të përcaktuar kushtetues. Përkundrazi, çdo përpjekje për të ndërmarrë veprime pas skadimit të afatit është juridikisht e pavlefshme dhe politikisht e papërgjegjshme.



Deputetët që tentojnë të veprojnë në kundërshtim me këtë afat bien ndesh me rendin kushtetues dhe shkelin obligimin solemn të dhënë me betim publik.

III. Ndërrhyrja e Gjykatës Kushtetuese: Masa mbrojtëse dhe ndalimi i veprimeve të mëtejme

Në kushtet e përshkallëzimit të krizës institucionale dhe vakumit kushtetues, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ndërhyri me vendosmëri, duke miratuar një masë të përkohshme mbrojtëse, me fuqi të menjëhershme dhe detyruese për të gjithë aktorët institucionalë. Kjo masë ndalon në mënyrë të qartë dhe taksative: Thirrjen e ndonjë seance të mëtejshme për konstituimin e Kuvendit; Zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit ose të ndonjë organi tjetër të tij; Miratimin e ndonjë akti apo vendimi parlamentar pas datës 26 korrik; Çdo pretendim se "procesi është

ende në zhvillim".

Çdo veprim që shkel këtë masë përbën cenim të drejtpërdrejtë të rendit kushtetues dhe mund të pasohet me konsekuenca juridike, përfshirë përgjegjësinë individuale për shkelje të Kushtetutës.

IV. Presidentja e Republikës: Garante e rendit kushtetues

Në këtë situatë të paprecedentë, presidentja e Republikës ka rol kushtetues të pazëvendësueshëm. Neni 84 i Kushtetutës përcakton qartë se Presidentja është garantuese e funksionimit të institucioneve kushtetuese dhe e rendit kushtetues në tërësi. Ky detyrim nuk është simbolik, ceremonial apo deklarativ - është një kompetencë e drejtpërdrejtë dhe obligim i prerë kushtetues. Nëse Gjykata Kushtetuese, më 8 gusht 2025, konstaton përfundimisht dështimin e procesit të konstituimit, atëherë Presidentja është e autorizuar dhe e detyruar të:

Shpërndajë Kuvendin e pakonstituuar; Shpallë zgjedhje të reja parlamentare, në afatet që përcakton Ligji për Zgjedhjet; Garantojë vazhdimësinë e institucioneve dhe stabilitetin kushtetues të vendit.

Çdo hezitim, zvarritje apo neglizhencë në marrjen e këtyre veprimeve do të përbënte shkelje të betimit kushtetues të Presidentes, e cila ka deklaruar solemnitet për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të ligjshmërisë.

V. Të ndalohen keqinterpretimet dhe manipulimet politike

Për të shmangur konfuzionin dhe mashtrimin publik, është thelbësore që: Të sqarohet qartë se nuk ka bazë ligjore për konstituim të vonuar; Nuk ekziston asnjë e drejtë për "vazhdimin" e seancës pas skadimit të afatit kushtetues; Deputetët që tentojnë të ushtrojnë funksione jashtë afatit, nuk përfaqësojnë më vullnetin legjitim të sovranit, por ndjekin qëllime politike të

papajftueshme me parimet e shtetit të së drejtës; Zbatimi i Kushtetutës nuk është çështje vullneti, por detyrim juridik dhe moral - dhe asnjë kompromis politik nuk mund të mbivendoset mbi normat themelore të shtetit.

VI. Shteti i së drejtës nuk duhet t'i nënshtrohet vullnetit politik

Sistemi kushtetues i Kosovës bazohet në: Ndarjen dhe balancimin e pushteteve; Funksionimin e rregullt dhe demokratik të institucioneve; Respektimin e detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Këto parime janë të panegociueshme dhe nuk mund të cenohen nga asnjë aktor, përfshirë partitë politike apo individë të caktuar që veprojnë në funksion të interesave të pushtetit dhe jo të shtetit.

Nëse e shkelim Kushtetutën për të ruajtur pushtetin, atëherë kemi humbur edhe vetë shtetin.

VII. Thirrje për veprim institucional dhe qytetar

Sot, më shumë se kurrë, kërkohet: Integritet dhe vendosmëri nga Presidentja e Republikës; Zbatim i pakushtëzuar i masës dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese; Vetëpërmbytje dhe përlulësi nga deputetët e Kuvendit; Përgjegjësi dhe qartësi nga media dhe shoqëria civile; Maturim dhe largpamësi nga të gjithë faktorët politikë dhe institucionalë. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurojmë ruajtjen e legjitimitetit të shtetit dhe besimin e qytetarëve në rendin demokratik dhe kushtetues të Republikës së Kosovës. Kosova është republikë parlamentare dhe shtet i së drejtës - askush nuk është mbi Kushtetutën.

Gucati: Gjykata Speciale po përpiqet ta barazojë luftën e UÇK-së me çetnikët serbë



PRISHTINË, 28 KORRIK - Një situatë jo fort e zakonshme ndodhi më 27 mars në Hagë, ku ish-presidenti Hashim Thaçi njohu prokurorin e Gjykatës Speciale, John Devaney, që më parë ka qenë gardian në Qendrën e Paraburgimit në Sheveningen. Kjo situatë solli tension në sallë dhe detyroi gjykatësin ta mbyllë seancën për publikun. Por a ishte kjo një lojë e Gjykatës Speciale? Lidhur me këtë zhvillim, në emisionin "Kosova Today" ka folur kryetari i OVLUÇK-së,

Hysni Guçati. "Kjo është hera e dytë, nuk është hera e parë. Ka ndodhur kur kemi qenë në burg unë dhe Nasimi. Në atë kohë ka qenë një njeri me emrin John, nëse nuk gaboj, me shtetësi amerikane. Ai ka qenë administrator i burgut që na ka sjell rendin shtëpiak të burgut, dhe pas një kohe e kemi parë që ka qenë prokuror në Gjykatën Speciale", tha fillimisht Guçati, duke bërë me dije edhe një herë se një zhvillim i tillë ka ndodhur edhe më parë. Guçati shton se me këto

veprime e kanë kuptuar se Gjykata Speciale, sipas tij, është duke bërë lojëra shumë të pista. "Ne e dimë që janë duke u shkelur të gjitha të drejtat e të burgosurve atje", tha kreu i OVLUÇK-së. Guçati shtoi se Specialja po përpiqet ta barazojë luftën e Kosovës me çetnikët serbë. "Unë mendoj se Gjykata Speciale po përpiqet ta barazojë luftën e UÇK-së me çetnikët serbë dhe ta minimizojë luftën e UÇK-së dhe shtetin tonë. Por nuk besoj se do ta arrijë këtë", deklaroi ai.

A PO E DËMTON KOTORIN STATUSI I UNESCO-S? NË MAL TË ZI S'PAJTOHEN DOT



PODGORICË, 28 KORRIK - Më shumë se 65 organizata joqeveritare kanë kërkuar shkarkimin e ministrit të Planifikimit Hapësinor, Sllaven Radunoviq, për shkak të deklaratës së tij se Mali i Zi duhet të mendojë nëse ka më shumë dëm apo dobi nga fakti që Kotori është nën mbrojtjen e UNESCO-s. Radunoviq më 24 korrik tha se mund të organizohet një referendum për qytetarët e Bokas lidhur me këtë çështje. Kotori, një qytet mesjetar në Boka Kotorska, gëzon statusin e trashëgimisë botërore që nga viti 1979 për shkak të vlerave kulturore dhe arkitektonike. Idenë për referendum e kanë hedhur poshtë autoritetet e Kotorit. “Do të bëjmë çfarë duhet. Perla do të mbetet perlë”, tha kreu i Kotorit, Vladimir Jokiq.

Çfarë e motivoi ministrin ta propozojë referendumin?

Deklarata e Radunoviqit erdhi pas mbledhjes së Komitetit për Trashëgiminë Botërore të UNESCO-s në korrik në Paris, ku u vlerësua se ka pasur përkeqësim serioz të ruajtjes së zonës natyrore dhe historiko-kulturore të këtij qyteti. Gjithashtu, u hap mundësia që Kotori të vendoset në Listën e Trashëgimisë Botërore në rrezik. Malit të Zi iu kërkuar vendosja e një moratoriumi mbi projektet ndërtimore në zonën e mbrojtur, që përfshin pjesë të

komunave Kotor, Tivat, Herceg Novi dhe Cetinje. “Duhet të mendojmë nëse na sjell më shumë dobi të jemi në UNESCO apo më shumë përfitim nëse mund të ndërtojmë. Këto janë dëme të mëdha”, tha Radunoviq. Ai shtoi se duhet hapur një debat publik mbi statusin e Kotorit. “Dhe të shpallet një referendum për qytetarët e Bokas që të shihet çfarë do të bëhet më tej dhe nëse duhet ende të jemi në UNESCO”, shtoi ai.

Statusi i trashëgimisë botërore në rrezik?

Sipas raportit të UNESCO-s, është theksuar se Mali i Zi nuk ka përmbushur rekomandimet kyçe që janë përsëritur për vite me radhë. Pikat problematike përfshijnë mungesën e ekspertëve, mungesën e një Studimi për Zonën e Mbrojtur, ligje të pakoordinuara dhe mungesë transparence në planifikim. Për këtë arsye UNESCO kërkon ndalim urgjent të lëshimit të lejeve të ndërtimit, ndryshime të ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ndalim të shfrytëzimit të burimeve natyrore në zonën e mbrojtur... Nevojitet gjithashtu një rishikim i planeve të zhvillimit urban për t'u përputhur me parimet e ruajtjes së vlerave të jashtëzakonshme universale, forcimi i institucioneve dhe krijimi i një sistemi transparent të menaxhimit.

Afati për zbatimin e masave përfundon në shkurt të vitit 2026. Ministria e Kulturës nuk iu përgjigj pyetjes së Radios Evropa e Lirë për koment mbi nismën e Radunoviqit, si dhe për pasojat nëse Mali i Zi nuk zbaton rekomandimet e UNESCO-s.

‘Jemi të barabartë me një fatkeqësi natyrore’

Kryetari i Komunës së Kotorit, Vladimir Jokiq, e hodhi poshtë idenë për referendum, duke theksuar se ruajtja e trashëgimisë kulturore është një detyrim civilizues. “Ruajtja e vlerave të jashtëzakonshme universale nuk mund të jetë objekt referendumi. As qeveria, as komuna, as qytetarët nuk duan të shkëputen nga qytetërimi”, tha Jokiq. Ish-ministria e Urbanizmit, Ana Novaković Gjuroviq, vlerësoi se deklarata e Radunoviqit për një referendum të mundshëm përfaqëson një qëllim të rrezikshëm të qeverisë për të shkatërruar Boka Kotorskën dhe për ta fshirë atë nga harta e trashëgimisë botërore. “Propozimi është absurd, jashtëzakonisht i papërgjegjshëm dhe tregon një mosnjohje themelore të fakteve dhe standardeve ndërkombëtare”, u shpreh Novaković Gjuroviq. Edhe dega e Kotorit e Lëvizjes “Evropa Tani”, e kryeministrit Miloško Spajiq, deklaroi se janë kundër idesë për organizimin e

çfarëdo referendumi. “Çështjet zhvillimore dhe infrastrukturore të Kotorit dhe Boka Kotorska janë të rëndësishme dhe kërkojnë qasje serioze, por zgjidhjet duhet të kërkojnë brenda kornizës që nënkupton ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike”, thanë nga Lëvizja “Evropa Tani”. Arkitektja Biljana Gligoriq tha se Kotori mund të përfshihet së shpejti në listën e kuqe të UNESCO-s. “Ka qenë një herë më parë në atë listë. Pas tërmetit. Ja si kemi kujdesur për të. Jemi të barabartë me një fatkeqësi natyrore për këtë perlë të planetit”, tha Gligoriq.

‘Statusi i UNESCO-s është njohje, jo pengesë’

Nëse Mali i Zi nuk i përmbush rekomandimet deri më 1 shkurt të vitit të ardhshëm, Kotori mund të përfshihet në Listën e Trashëgimisë Botërore në Rrezik - një regjistër ndërkombëtar i vendeve që përballen me kërcënime serioze ndaj vlerave universale. Statusi i trashëgimisë botërore që gëzon Kotori nën mbrojtjen e UNESCO-s përfaqëson njohje për vlerat e tij të jashtëzakonshme universale, thuhet në deklaratën e 65 organizatave joqeveritare. “Humbja e këtij statusi do të sillte pasoja afatgjata - rënie të besimit, ulje të investimeve, humbje të interesit nga partnerët ndërkombëtarë dhe dëmtim të reputacionit të

shtetit”, deklaruan organizatat joqeveritare. Heqja dorë nga statusi i UNESCO-s do të nënkuptonte lënien e hapësirës vetëm në dorën e logjikës së tregut, duke anashkaluar interesin publik dhe identitetin kulturor, u shpreh sektori civil.

Shembuj të humbjes së statusit të UNESCO-s

Në raste ekstreme, një lokacion mund të hiqet plotësisht nga lista e UNESCO-s, siç ndodhi me Luginën e Elbës në Dresden të Gjermanisë dhe me portin e Liverpulit. Lugina e lumit Elba pranë Dresdenit ishte vendi i parë në Evropë dhe i dyti në botë që u hoq nga lista e Trashëgimisë Kulturore Botërore të UNESCO-s. Dresdeni është një nga qytetet e rralla në Gjermani që ka ruajtur pamjen e tij prej 250 vitesh. U hoq nga lista sepse autoritetet vendosën të ndërtojnë një urë moderne me katër korsi mbi lumin. Sipas Komitetit të Trashëgimisë Botërore, ndërtimi i urës nuk e ruante vlerën universale të jashtëzakonshme të luginës së lumit Elba. Më parë, në vitin 2007, UNESCO kishte fshirë nga lista Rezervatin e oriksit arab (një lloj i rrallë antilope) në Oman, pasi autoritetet vendase e zvogëluan zonën e mbrojtur me 90 për qind, duke shkatërruar vlerën universale të jashtëzakonshme të asaj zone. (REL)

OEK-u kërkon pezullimin e tregut të lirë të energjisë deri më 1 shkurt

PRISHTINË, 28 KORRIK - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, në një konferencë për medie ka shprehur shqetësimin e madh të komunitetit të biznesit për pasojat që po sjell kalimi në tregun e lirë të energjisë elektrike. Rafuna në një konferencë për medie i ka bërë thirrje Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) ta pezullojë zbatimin e

këtij sistemi deri më 1 shkurt, duke theksuar se shumë biznese nuk kanë arritur të sigurojnë oferta të favorshme për furnizim me energji. “Përkundër kërkesave të vazhdueshme nuk kemi hasur në mirëkuptim. Pasoja tashmë kanë filluar të ndihen dhe do të jenë të rënda për prodhuesit dhe bizneset të cilat nuk do të mund t’i përballojnë kostot në rritje”,

tha Rafuna. Ai ka theksuar se importi është rritur 12 për qind dhe se rritja e çmimit të energjisë do të ndikojë drejtpërdrejt në çmimin e prodhimeve vendore, duke i bërë ato jokonkurrense në raport me produktet e importit. Sipas Rafunës, eksporti tashmë ka filluar të bie dhe rrezikohet pozita e bizneseve në tregjet ndërkombëtare. Ai shtoi se

shumë kompani janë detyruar të lidhin kontrata për energji në kushte të pafavorshme për shkak të mungesës së ofertave. “Ky vendim i ZRRE-së nuk është në interes të bizneseve. Kërkojmë që institucionet ta marrin përgjegjësinë e tyre, ndërsa ne do ta ndjekim rrugën ligjore për ta kërkuar pezullimin e këtij procesi. Bizneset duan të jenë pjesë e një tregu të lirë me



konkurrencë të drejtë, por jo në rrethana të papërgatitura”, ka thënë Rafuna.

SUPREMJA SHFUQIZON NENE TË CAKTUARA TË UDHËZIMIT ADMINISTRATIV PËR PAGESAT DIREKTE NË BUJQËSI

PRISHTINË, 28 KORRIK - Gjykata Supreme ka shpallur të paligjshme dhe ka shfuqizuar disa nene të Udhëzimit Administrativ për Pagesat Direkte në Bujqësi. “Kolegji i Gjykatës Supreme, në çështjen juridike në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses: ‘Stonecastle Vineyards & Winery’ Sh.p.k, të cilën e përfaqësojnë sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve ‘Vokshi & Lata’, më avokatët Florin Lata dhe Urin



Vokshi, më seli në Prishtinë, kundër të paditurës: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Nadir Shyqeriu, avokat nga Avokatura Shtetërore nga Ministria e Drejtësisë, me bazë juridike: shfuqizimin e aktit nënligjor normativ, Udhëzimin Administrativ (MBPZhR) Nr.04/2025, për Pagesat Direkte në Bujqësi për Vitin 2025, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur në praninë e palëve

ndërgjyqëse, më datë 14.07.2025, ka aprovuar të themeltë kërkesëpadinë e paditëses: ‘Stonecastle Vineyards & Winery’ të paraqitur kundër të paditurës: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), me seli në Prishtinë”, ka njoftuar Gjykata Supreme. Në njoftim është thënë se janë shfuqizuar neni 21, paragrafi 2, nënparagrafët 2.1 dhe 2.2, të Udhëzimit Administrativ për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2025.

PRONARI I “AMBRELLA KUMANOVË”, PRODHUES I ROLETAVE TË ALUMINIT ME LICENCË ZVICERANE, VIZITON AKB-NË



PRISHTINË, 28 KORRIK - Në ambientet e Aleancës Kosovare të Bizneseve, kryetari Agim Shahini ka pritur Sami Mustafën, pronarin e fabrikës “Ambrella Kumanovë”, e cila prodhon roleta ekskluzive nga alumini me materiale 100 % zvicerane, gjermane dhe italiane të certifikuara.

Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, së bashku me anëtarin e Bordit, Shkëlzen Jusaj, diskutuan me Mustafën për mundësinë që produktet e kësaj kompanie të shpejti të jenë të pranishme edhe në tregun e Kosovës, duke u bërë pjesë e komunitetit të bizneseve të Kosovës, njëkohësisht anëtare e

AKB-së. “Produktet tona janë ekskluzive, të certifikuara, me mekanizma digjitalë dhe garanci deri në 10 vjet. Kosova është një treg gjithnjë e më interesant, sepse ndërtimi këtu ka kaluar nga emergjenca në ekskluzivitet, me kërkesë për produkte të qëndrueshme dhe moderne”, ka

thënë Sami Mustafa. Shahini ka thënë se AKB-ja dhe Kosova do të jenë gjithmonë derë e hapur për prodhues serioz si “Ambrella”, duke promovuar cilësinë dhe inovacionin në tregun tonë. “Mirë se vini në Kosovë me produkte tuaja dhe mirë se vini në AKB!”, ka thënë Shahini.

AUV-i SHFUQIZON NDALESËN E IMPORTIT TË KAFSHËVE TË GJALLA NGA HUNGARIA ME PËRJASHTIM TË DY ZONAVE

PRISHTINË, 28 KORRIK - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ka shfuqizuar ndalesën për importin e kafshëve të gjalla dythundrake (gjedhe, dele, dhi dhe derra) dhe produkteve të tyre nga Hungaria, përjashtuar zonat administrative Kisbajecs dhe Gyor-Moson-Sopron. AUV-i ka njoftuar se ky vendim është marrë më 25 korrik 2025 në

përputhje me Ligjin e Veterinarisë dhe pas vlerësimeve të fundit nga organizatat evropiane për shëndetin e kafshëve mbi situatën epidemiologjike të sëmundjes “Afta Epizootike”. Sipas AUV-it, ky ndryshim i masës kufizuese është në linjë me vendimet e shteteve të tjera dhe vjen si rezultat i mosregjistrimit të asnjë rasti të dyshuar në Kosovë. “Falë

vendimeve dhe veprimeve profesionale të menjëhershme të AUV-së, në koordinim me vendet tjera. Kosova e kaloi situatën me sukses, duke mos regjistruar asnjë rast të dyshuar për prezencë të sëmundjes ‘Afta Epizootike’ ne vend. Jemi të përkushtuar me angazhim të plotë, ti dalim në ballë secilës situatë për të ruajtur shëndetin veterinar në vend.

Duke mbrojtur ekonominë e fermerëve dhe ekonominë shtetërore. Falë masave të vendosura, mbikëqyrjes se zbatimit në përpikëri nga organet shtetërore që punojnë në kufij MIK. Sot po ndodh lehtësimi i kufizimit për qarkullim të mallrave mes dy vendeve. Gjithmonë duke respektuar protokollet veterinarë”, ka njoftuar AUV-i.




Ndëshkohen marketet për mospërputhje të çmimeve në raft dhe arkë

GJILAN, 28 KORRIK - Inspektorët e komunës së Gjilanit po vazhdojnë kontrollin e çmimeve dhe gjobitjen e marketeve të cilët kanë çmime më të lira në rafte e më të shtrenjta kur paguhen tek arka. Pas ankesave të konsumatorëve, inspektorët kanë dalë në terren

për t’i konfirmuar mashtrimet që po bëhen ndaj konsumatorëve, që ndryshe i shohin çmimet në rafte e obligohen të paguajnë ndryshe tek arka. Drejtoria e Inspeksionit në Gjilan ka njoftuar se tash me ardhjen e mërgimtarëve në vendlindje, inspektorët kanë shtuar kujdesin

që pagesat të jenë sipas çmimeve në raftet e marketeve, me qëllim që mos të zhvaten konsumatorët. “Apelojmë te qytetarët, që të raportojnë rastet kur hasin në mospërputhje me çmimet që janë në raft dhe ndryshojnë tek arka”, kanë theksuar nga Drejtoria e Inspeksionit.

Ata tregojnë se inspektorët kanë shqiptuar edhe gjoba në vlerë rreth 400 euro dhe se parregullsitë e tilla nuk do të lejohen. Inspektorët po vazhdojnë punën pa ndalur dhe çdo ankesë e konsumatorëve do të trajtohet me kujdes.



EVROPA E SHTRËNGUAR NË MORSË MES RUSISË, KINËS DHE TRUMPIT

Recetat e vjetra nuk bëjnë më punë



Stefano STEFANINI

Evropa, projekti evropian i paqes dhe begatisë, nuk ishte ndërtuar për botën që e rrethon sot. Këtë e themi shumë shpesh. Është koha të ankohemi më pak dhe të përshtatemi me një realitet ndërkombëtar që nuk po afrohet më me ëmbëlsinë e kohëve më të mira. Dy janë rrugët e mundshme: një Bashkim Evropian më i fortë, si ai që parashikohet në propozimin për buxhetin shumëvjeçar 2028-2034, sapo paraqitur nga Presidentja e Komisionit Ursula von der Leyen – sepse për të qenë të fortë duhen burime, jo vetëm fjalë; ose, një logjikë e forcimit të kryeqyteteve të shteteve anëtare, drejtim në të cilën po lëviz trekëndëshi Paris-Londër-Berlin, i ashtuquajtur E3, që po forcon me shpejtësi bashkëpunimin ndërqeveritar në mbrojtje dhe siguri, por jo vetëm – marrëveshja dypalëshe franko-britanike prek edhe emigracionin e paligjshëm përmes Kanalit të La Manshit, një temë e nxehtë për opinionet publike të brendshme. Le të përpiqemi ta shikojmë skenën ndërkombëtare pa paragjykim. Jemi të rrethuar nga bota e Vladimir Putinit, që

ka rikthyer luftën – më falni, “operacionin special” – në zemër të kontinentit, duke sulmuar, sipas tij, një popull “vëlla” i cili, ndoshta, pas mijëra dronëve dhe bombave, ndjen mungesën e asaj vëllazërie. Nga konkurrenca e pamëshirshme tregtare dhe teknologjike e Kinës – e cila nuk është pranë, por tashmë është brenda nesh, mjafton të hysh në një “3J casa market” ku gjen gjithçka me çmime qesharake, sigurisht të prodhuara në Kinë, por të shpërndara nga Prato. Ndërkohë, presim edhe makinat elektrike kineze, më pak të shtrenjta se tonat dhe teknologjikisht më të avancuara. Nga gishti i lehtë mbi këmbëz i Benjamin Netanyahu, i cili tashmë zgjidh çdo problem të brendshëm me një ndërhyrje ushtarake dhe vazhdon pa u ndalur luftën në Gaza me objektivin fillestar – të eliminojë kërcënimin nga Hamasi – por që ka përfunduar nën rrënoja dhe me dhjetëra viktime civile çdo ditë. Sa prej tyre janë terroristë të Lëvizjes së Rezistencës Islamike? Apo nga arroganca e Zotërisë së luftës së Bengazit, Khalifa Haftar, i cili nuk hezitoi të dëbonte Komisionerin e BE-së për Migracionin, Magnus Brunner, dhe tre ministrat që e

shoqëronin, mes tyre edhe italianin Matteo Piantedosi, në një mision diplomatik. Do të ishte më e kollajtë të kishin “takuar” Muammar Gaddafi. Nga mesazhet në rrjetet sociale të Donald Trump-it – prej të cilëve, për fat të mirë, do ta mësojmë deri më 1 gusht nivelin e tarifave që ai do të vendosë, të cilat variojnë nga 10% deri në 30%. Diferenca është e madhe, siç e di çdo eksportues. Kjo “stuhi e përsosur”, për më shumë se një të katërtën e globit, i pret rrënjët Evropës që në fillim të këtij shekulli. Një Evropë e përshtatur në një kontekst sigurie sociale dhe mirëqenieje të shpërndarë, falë nivelit të lartë të industrializimit dhe sektorit të tretë. Një Evropë që zgjerohet paqësisht drejt Lindjes, me kërkesën e atyre që duan të marrin pjesë, drejt një sfere të shtetit të së drejtës dhe demokracisë. Një Evropë, pa ambicie egoiste, që beson se ka një rol natyral në Mesdhe – për të cilin, kujtojmë, janë shtatë shtete që kanë dalje në “Mare Nostrum”: Spanja, Franca, Italia, Malta, Kroacia, Greqia dhe Qipro. Një Evropë gjysmë e çarmatosur, por që pse të shqetësohet? Amerikanët janë aty. Por këto themele janë

sistematikisht të krisura. Europa përballet me penetrimin konkurrues të ekonomisë kineze në tregjet e saj tradicionale – shih Afrikën apo Amerikën Latine. Ajo vuan nga një irrelevancë faktike në Lindjen e Mesme: në luftërat e Izraelit, pas 7 tetorit, nuk ka luajtur asnjë rol. Dhe, mbase, ka lënë fushën e lirë për Turqinë, Rusinë, Emiratet, Egjiptin – në Libi për shembull? Rusia e Putinit e ka hequr maskën më 24 shkurt 2022: është një fuqi e madhe ushtarake, bërthamore dhe energjetike, që ndjek një politikë revizioniste për të ndryshuar ekuilibrat evropianë. Por më tronditësja është Amerika e re, Amerika e Donald Trump-it. Ende mike për sigurinë, por nuk e dimë në çfarë kushtesh – shpresojmë të mos e mësojmë. Mund të jetë me Ukrainën, ndoshta, veçanërisht nëse patriotët e Kievit kanë nevojë për armë që ne i blejmë për ta. Por për Trump-in, “business is business”, dhe ai mund të ndërrojë mendje pas një telefonate midis Shtëpisë së Bardhë dhe Kremlinit, ose pas një samiti në Riad. Siguria bëhet, hapur, rivalitet ekonomik. Dhe nëse Trump vendos disa tarifa që hyjnë në fuqi nga 1 gushti – do të negociojmë – por nuk

ndryshon fakti themelor: vizioni i administratës Trump për Europën është kundërshtar. Përveç nëse Europa ndahet, siç e shpjegonte Marta Dassù për Repubblica, pas një vizite të qartë në Heritage Foundation, institut konservator shumë pranë presidentit. Përça dhe sundo. Dhe mbase përfiton edhe Groenlandën. Çfarë duhet bërë për të lundruar në këto stuhi ndërkombëtare dhe për të mbajtur kokën mbi ujë përballë një “America First”, me të cilën kemi ende lidhje shumë të forta? A duhet të mbështetemi në një BE më të fortë apo në kapitale kombëtare më të fuqishme? Të dyja duhen, për aq kohë sa e para është më solide dhe e strukturuar, por më e ngadaltë, ndërsa e dyta është më e menjëhershme, më elastike dhe më e zhdërvjellët. Dhe, për çështje sigurie dhe mbrojtjeje, britanikët janë të domosdoshëm. Italia e Giorgia Melonit është e paralajmëruar. Ka hapësirë për Romën. Por nëse nuk angazhohet në Bruksel dhe nuk lidhet me trekëndëshin Paris-Londër-Berlin (E3), do të mbetet në periferi të lojës ndërkombëtare dhe jashtë rrethit të fuqive. Që nuk e quan veten të tillë, por është. / La Stampa – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Club Brugge refuzon ofertën përfundimtare të Milanit për Jasharin

Club Brugge ka refuzuar ofertën më të fundit të Milanit për mesfushorin zviceran Ardon Jashari, duke shprehur pakënaqësi të hapur ndaj mënyrës se si janë menaxhuar negociatat nga

klubi italian. Sipas ekspertit belg të merkatos Sacha Tavolieri, Brugge ka thënë “jo” ndaj ofertës së fundit të Milanit, që ishte në vlerë prej 33.5 milionë eurosh plus bonuse – ende nën kërkesën

prej 40 milionë eurosh që ka vendosur klubi belg. Deklaratat e Tares irritojnë drejtuesit belgë. Situata është përshkallëzuar pasi drejtori sportiv i Milanit, Igli Tare, deklaroi të dielën se: “Kjo

është oferta jonë përfundimtare. Nuk do të ketë propozime të tjera për Jasharin.” Këto deklarata publike, të bëra vetëm disa orë para debutimit të Club Brugge në sezonin e ri të

Belgian Pro League, nuk u pritën mirë nga drejtuesit belgë. Sipas Matteo Moretto, ata e konsideruan të papërshtatshme dhe të dëmshme qasjen publike të Milanit.

SHKËLZEN LUSHTAKU LARGOHET NGA DRENICA PAS 23 VJETËSH

“Epoka e re”

SKENDERAJ, 28 KORRIK - Futbollisti legjendar i Drenicës, Shkëlzen Lushtaku, është larguar nga klubi kuqezi pas plot 23 vjetësh. Lajmin e ka dhënë Lushtaku në “Facebook”. Lushtaku që e barti edhe shiritin e kapitenit në skuadrën nga Skenderaj ka thënë se Drenica do të mbetet gjithmonë pjesë e shpirtit të tij, derisa ndihet krenar se ka dhënë gjithmonë maksimumin për këtë klub. “Faleminderit, Drenica ime! Me zemër të mbushur plot krenari dhe emocione, po shkruaj këto fjalë për klubin që ishte dhe do të mbetet gjithmonë pjesë e shpirtit tim. Që nga hapat e parë në futboll, që nga ditët e rinisë sime, e deri më sot – unë e kam jetuar këtë rrugëtim me pasion të singertë dhe dashuri të pakusht. Për më shumë se 23 vite në këtë fushë, dhashë gjithçka që pata: djersën, mundin, shpirtin dhe zemrën time. Dhe po të kthehesha prapa, do ta zgjidhja sërish të njëjtën rrugë - pa asnjë hezitim! Kam qenë krenar që isha pjesë e Drenicës, dhe sot largohem nga fusha si një njeri i lumtur, sepse largohem si kampion! Në ditët më të vështira të këtij klubi, dhashë gjithçka që të arrinin aty ku e meritoni – në majë, me dinjitet dhe nder”, ka thënë Lushtaku, i cili më pas ka falënderuar familjen, presidentet e klubit, bashkëlojtarët dhe trajnerët si



dhe tifozët “Shqiponjat e Zeza”. “Faleminderit të gjithë presidentëve të klubit për besimin dhe mbështetjen! Faleminderit çdo bashkëlojtar që ndau me mua dhimbjen dhe gëzimin e këtij udhëtimi! Faleminderit të gjithë trajnerëve që punuan me mua dhe që më ndihmuan të rritem, si lojtar dhe si njeri! Një mirënjohje e veçantë për: Afrim Jasharin, Tahir Lushtakun dhe Fadil Ramën - që më udhëhoqën me përkushtim dhe zemër. Faleminderit nga zemra “Shqiponjat e Zeza”, tifozët tanë besnikë, që nuk na lanë vetëm as në ditët më të vështira. Dashuria juaj ka qenë forcë për ne! Dhe, mbi të gjitha:

faleminderit familjes sime që më qëndroi pranë në çdo moment, ndau me mua çdo sfidë dhe ishte gjithmonë forca ime më e madhe”, ka shtuar ai. Lushtaku më pas ka bërë me dije se shumë shpejt do të bëjë publike të ardhmen e tij. “Sot largohem nga fusha, por jo nga Drenica. Sepse Drenica nuk është vetëm një klub. Është zemra ime, është identiteti im, është jeta ime. Edhe pse fizikisht nuk do të jem më në fushë, me zemër do të jem gjithmonë aty - me ju, me Drenicën time të dashur. Së shpejti do t’ju njoftoj për të ardhmen time. Përjetësisht me ty, Drenica ime!”, ka përfunduar Lushtaku.

SHKURT

Kosova U19 e fiton edhe miqësoren e dytë me Kuvajtin

Hendbollistët e Përfaqësueses U19 të Kosovës e kanë zhvilluar të dielën edhe miqësoren e dytë me Kuvajtin. Në Velenje të Sllovenisë djemtë tanë fituan 26:21. Ndaj Kuvajtit, Kosova fitoi edhe dy ditë më parë. Ka pasur përmirësime në elemente të lojës së “dardanëve” në krahasim me ndeshjen e parë. Pas dy ditësh është edhe një miqësore tjetër, që shërben për përgatitje sa më të mirë për Kampionatin Botëror U19 në Egjipt.

Istref Elezaj në CEV U16, Kampionatin Evropian në Armeni

Gjyqtari Istref Elezaj po shkëlqen në CEV U16 Kampionatin Evropian të djemve që po zhvillohet në Jerevan të Armenisë. Që nga dita e parë Elezaj po ndan drejtësinë në fushë, duke gjykuar ndeshjen Letonia - Sllovenia së bashku me suedezin Magnus Hagstrom. Me 5 ndeshje të gjykuara në mesin e elitës evropiane dhe dy prej tyre si gjyqtarë kryesorë, Elezaj ka treguar nivel të lartë profesionalizmi. Kujtojmë se ai është gjyqtari i parë nga Kosova që ka marrë thirrje nga FIVB. Kampionati i 16-vjeçarëve përfundon më 3 gusht 2025 me finalen e planifikuar në atë datë, kurse pritët që Elezaj të vazhdojë të jetë pjesë e ndarjes së drejtësisë në ndeshjet e ardhshme.

Futbollistja Qëndresa Krasniqi transferohet te Grasshoppersi

Futbollistja nga Kosova, Qëndresa Krasniqi, ka kaluar te Grasshopperi. Ajo deri më tani ka luajtur për skuadrën tjetër zvicerane, Basel. 31-vjeçarja është një prej lojtareve më të mira që ka vendi, fjalë të mëdha për të cilën pati edhe drejtori i ri i Grasshoppersit, Theo Karapetas. “Qëndresa është shumë e mirë teknikisht dhe e njeh ligën shumë mirë. Me përvojën e saj do të jetë përkrahje e rëndësishme për ne”, deklaroi ai. Mesfushorja sa i përket kombëtares luan për Shqipërinë, duke qenë ndër më kryesoret. Pos në Kosovë e Shqipëri, Krasniqi ka bërë karrierë edhe në skuadra zvicerane si Yverdon, Aarau dhe Basel.

Leverkuseni pranon ofertën e Sunderlandit për Granit Xhakën

SUNDERLAND, 28 KORRIK - Granit Xhaka do të transferohet te Sunderlandi për 20 milionë euro, sipas gazetarit të njohur Fabrizio Romano i cili ka njoftuar transferimin e mesfushorit shqiptar te klubi anglez. Sipas raportimeve, Xhaka, i cili deri më tani luante për Bayer Leverkusenin, do të bashkohet me “Black Cats” për një shumë prej 20 milionë eurosh. Kontrata

e tij me Sunderlandin do të zgjasë deri në vitin 2027. Ky transferim vjen pas dritës jeshile nga Bayer Leverkuseni, me Xhakan që pritët të udhëtojë për ta finalizuar lëvizjen e tij. 32-vjeçari, i cili luajti një rol kyç në titullin e parë të Bundesligës të Leverkusenis sezonin e kaluar, shihet si një goditje e madhe për Sunderlandin, të cilët sapo u rikthyen në Ligën Premierë. Klubi

anglez ka investuar fuqishëm këtë verë, duke siguruar edhe lojtarë të tjerë, në përpjekje për të ndërtuar një ekip konkurrues. Xhaka, i cili ka një karrierë të suksesshme me mbi 300 paraqitje tek Arsenali, duket se ka zgjedhur Sunderlandin si destinacionin e tij të preferuar, pavarësisht interesimit nga klube të tjera, sidomos ato italiane.



Guardiola përjashton rikthimin te Barça: Është një histori që ka përfunduar

MANCHESTER, 28 KORRIK - Pas një sezoni të vështirë në krye të Manchester Cityt, Pep Guardiola është i vendosur ta nisë një sezon tjetër në Angli. Trajneri katalanas ka punuar intensivisht javët e fundit për ta përgatitur skuadrën në prag të sezonit të ri të Premierë Ligës, që starton më 18 gusht, me një sfidë në

transferti ndaj Wolverhamptonit. Siç ndodh shpesh, emri i Guardiols është përfolur sërish në lidhje me një rikthim të mundshëm te Barcelona, klubi i zemrës me të cilin fitoi gjithçka mes viteve 2008-2012. Por, këtë herë, tekniku e ka mbyllur përfundimisht derën për një rikthim në

Katalonjë. “Barcelona? Është e mbyllur. Përgjithmonë. Ka qenë shumë bukur, por është një histori që ka përfunduar”, ka thënë Guardiola në një deklaratë të prerë, duke shuar çdo iluzion për një rikthim në “Camp Nou”. Me këtë qëndrim të qartë, Guardiola konfirmon përkushtimin ndaj të

tashmes dhe projektit të Manchester Cityt, me synimin për ta rikthyer skuadrën në majat e futbollit anglez dhe evropian. Në horizont, për trajnerin katalanas nuk përjashtohet një aventurë ndryshe në të ardhmen, ndoshta me një kombëtare, por jo më me Barcelonën.



Të gjithë në Rubin e ngrehin në qiell Mirlind Dakun

KAZAN, 28 KORRIK - Mediet në Rusi i kanë kushtuar shumë vëmendje golit të Mirlind Dakut ndaj Zenit St. Petersburgut në kuadër të kampionatit rus. Gjatë afatit kalimtar veror ishte përfolur gjatë një kalim i mundshëm i Dakut nga Rubin Kazani te Zeniti, por transferimi nuk u realizua. Daku qëndroi te Rubini dhe të dielën u bë hero i skuadrës, duke shënuar në minutën e 90 për barazimin 2-2. Golin e parë për Rubin e realizoi reprezentuesi i ri i Kosovës, Veldin Hoxha. Trajneri i Rubin Kazanit, Rashid Rakhimov, u pyet nëse kjo ndeshje kishte rëndësi të veçantë për Dakun. Ai pranoi se Daku nuk pati paraqitjen më të mirë, por theksoi rëndësinë e golit të tij. “Ai duhet ta kuptojë se të gjitha ndeshjet janë speciale për të. Ai ka një nivel të caktuar, por nuk e mban atë gjatë 90 minutave. Kur fillon, çdo gjë është e qartë. Çfarë dallimi bën nëse ka kaluar në Zenit apo jo? Janë



të gjitha ndeshje kampionale, ju vetëm duhet ta mbani nivelin, stabilitetin dhe të zhvilloheni tutje”, ka thënë Rakhimov. Kapiteni i Rubin Kazanit, Igor Vujačić, ka lavdëruar Dakun, duke e cilësuar ndër më të mirët në Rusi dhe me potencial për të luajtur në La Liga. “Duhet të prisni momentin që ai të realizojë. Mbrojtësit e Zenitit kanë luajtur

mirë ndaj tij. Ishte e vështirë për të, është dashur të bëjë shumë pa top. Por në pjesën e dytë gjeti momentin e tij. Kjo është forca e Dakut”, ka thënë Vujačić. Mbrojtësi i Zenitit, Vanja Drkushiq, dhe trajneri Sergei Semak gjithashtu kanë vlerësuar Dakun, duke e cilësuar atë si një nga lojtarët më të mirë në kampionatin rus.

Usyk: Ja tri arsyet pse jam ende kampion i pamposhtur

SIMFEROPOL, 28 KORRIK - Boksieri ukrainas Oleksandr Usyk iu rikthye kampionit të padiskutueshëm të peshave të rënda ashtu siç duhej, me një goditje të bukur ndaj Daniel Dubois, duke i marrë sërish të gjithë titujt e këtij Divizioni. 8 nga 9 rivalët e tij të fundit ishin anglezë dhe të gjithë kanë përfunduar me humbje. “Nuk është asgjë personale, është thjesht sport. Historia ime kundër anglezëve pasqyron nivelin e lartë të boksit të tyre. Dhe kam mbetur në marrëdhënie të mira me shumicën e kundërshtarëve të mi; ata janë djem të mirë dhe luftëtarë fisnikë. Jam mirënjohës ndaj anglezëve për mbështetjen e tyre ndaj Ukrainës që nga fillimi i pushtimit të vendit tim”, ka thënë Usyk. Duke iu rikthyer fitores ndaj Dubois, ai ka deklaruar: “Pas çdo kampioni, ka tre gjëra: disiplina, pasioni dhe një ekip që e mbështet atë. Pra, mund ta shihni se unë dhe ekipi im i bëmë detyrat e shtëpisë mirë. Ne analizuam ndeshjet e mia



dhe të tijat, studiuam situatat që mund të lindnin, identifikuam pikat e forta, të dobëta dhe gabimet. Dhe, bazuar në këtë, zhvilluam strategji. Pastaj i stërvitëm ato dhe i vumë në praktikë”. “Tani për tani, dua vetëm të kaloj kohë me familjen time. Do t’ia lë Zotit atë që ndodh në të ardhmen”, ka thënë Usyk në lidhje me rivalin e radhës pa përmendur emra dhe më pas shtoi: “Jam i sigurt se Zoti ka planet më të

mira të mundshme për mua”. Duke folur për faktin se është i pamposhtur, ai shtoi: “Jam në kulmin e forcës sime, si fizikisht ashtu edhe mendërisht. Do të luftoj edhe një herë. Pastaj do t’u kushtoj më shumë kohë të dashurve të mi. Nuk kam motivim, kam disiplinë. Gjithçka fillon në mendje. Ajo që bën diferencën është mentaliteti me të cilin përballemi me sfidat më të mëdha”.

SHKURT

Verstappenin nuk largohet nga Red Bull

Zërat për një kalim të mundshëm të Max Verstappenit te Mercedesi janë shuar, pasi katër herë kampioni i botës do të qëndrojë te Red Bull, ku ka kontratë deri në vitin 2028. Spekulimet u ndezën pas një deklaratë të Nelson Piquet Jr., kunati i Verstappenit, por Toto Wolff i ka mbyllur ato duke konfirmuar George Russell dhe Kimi Antonellin për vitin 2026. Ndërkohë, Verstappenin nuk e aktivizon dot klauzolën e daljes nga kontrata, pasi ndodhet në vendin e tretë në renditje, pas Oscar Piastri dhe Lando Norris. Maxi është i kënaqur me drejtuesin e ri Laurent Mekies dhe synon të përgatitet për sezonin 2026 me ndryshime të mëdha teknike. Përfundimisht, ai mbetet i vendosur të vazhdojë me Red Bullin, ndërsa gara e radhës do të zhvillohet në Hungari.

Eto'o kujton ardhjen e tij tek Interi dhe ngacmon Ibrahimoviçin

Më 27 korrik, 16 vjet më parë, Moratti dhe Laporta ranë dakord për marrëveshjen e shkëmbimit Ibrahimoviç-Eto'o. “Nënshkrimi im më sensacional, madje më shumë se Ronaldo”, ka deklaruar më vonë ish-presidenti i zikaltërve me një zgjidhje prej 50 milionë eurosh në favor të zikaltërve. “Marrëveshja më e mirë në historinë e futbollit”, ka shkruar sulmuesi kamerunas në rrjetet sociale pas kaq shumë vitesh. 16 vjet më vonë, ai mezi pret ta kujtojë atë ditë, duke etiketuar Interin, Barcelonën dhe... Ibrahimoviçin në Instagram. Sulmuesi suedez fluturoi te Guardiola sepse donte me dëshpërim të fitonte Ligën e Kampionëve, të cilën zikaltrit e fituan po atë vit dhe u ngrit nga Zanetti në qiellin e Madridit. Ndër komentet nën postim, spikat ish-shoku i skuadrës Marco Materazzi, i cili nuk humbet kurrë mundësinë për të theksuar se si ai shkëmbim ndryshoi të gjithë sezonin 2009-2010 dhe për t’i dhënë një goditje rivalit të tij të përjetshëm Zlatan. Ish-mbrojtësi komentoi me tri kupa dhe fytyra që qeshnin, grumbulloi një mori pëlqimesh.

Leclerc: Ferrari është në rrugën e duhur

Piloti monegask i Ferrarit, Charles Leclerc, është larguar nga Belgjika i kënaqur me përditësimet e bëra në makinën SF-25, të cilat i lejuan ta merrte podiumin e tij të pestë të sezonit (u renditi i treti). Megjithatë, makina McLaren është ende në një planet tjetër, me të dy pilotët e saj që zunë dy vendet e para. “Max ishte prapa gjatë gjithë garës me një diferencë prej dy sekondash, kështu që nuk është kurrë e lehtë. E dija që xhiroja e parë do të ishte më e vështira sepse nuk kishim të njëjtën ngarkesë si McLaren ose Red Bull por, për fat të mirë, pista u tha mjaft shpejt dhe ritmi ishte i mirë”, ka thënë Leclerc. “Jam i lumtur që arritëm ta mbanim vendin e tretë, sepse presioni në ato kushte është i lartë, dhe në një moment të caktuar i thashë Bryan të më linte rehat. Natyrisht, ai po përpiqej të më jepte sa më shumë informacion të ishte e mundur. Ndonjëherë është i dobishëm, por ndonjëherë jo”, ka shtuar ferraristi. “Mendoj se është një fundjavë ku nuk kemi keqardhje, kështu që jam i lumtur. Duhet të jemi të kujdesshëm me pozitivitetin dhe të mos krijojmë pritje të rreme. Mendoj se jemi në rrugën e duhur, gjithashtu mendoj se kemi ende shumë për të bërë për të kapur McLarenin dhe Red Bullin e Maxin. Po vazhdojmë të punojmë kështu dhe po bëjmë një punë të mirë”, ka deklaruar Leclercu.

Bayerni arrin marrëveshje me Luis Diazin

Ylli i Liverpoolit, Luis Diaz, është shumë pranë transferimit në Bayern Munchen. Klubi gjerman ka arritur marrëveshje me klubin

anglez për blerjen e sulmuesit kolumbian në një marrëveshje me vlerë 70 milionë euro tarifë fikse, plus 5 milionë euro bonuse që mund të aktivizohen

në bazë të performancës. Diaz do të mbërrijë në Mynih të martën, ku do t’i kryejë testet mjekësore të planifikuara për të njëjtën ditë. Sipas burimeve

pranë klubit, ai do të nënshkruajë një kontratë katërvjeçare me opsion për një vit shtesë (4+1), e vlefshme deri në verën e vitit 2029. Ky

transferim përforcon ndjeshëm krahun e majtë të sulmit te Bayerni, me Diazin që pritet të jetë një element kyç në skemat e trajnerit Kompany.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Moler Fasader Rudina” SH.P.K. me seli në Rahovec, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812150291 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Moler Fasader Rudina” D.O.O. Rahovec donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812150291 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Moler Fasader Rudina” L.L.C. with headquarters Rahovec, has come to the decision to quit its business: 812150291 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Energy Development Group
Madanaj
RKS – 50 000 Gjakovë

NJOFTIM

Licencimi i Aktivitetit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë në Kosovë (solare)

Energy Development Group – Kosova L.L.C., me seli në Gjakovë me adresë në fshati Madanaj, rruga. Qafa, p.n.përmes procedurës së Autorizimit për Ndërtim të Kapaciteteve të Reja, ka ndërtuar gjeneratorin e energjisë elektrike të quajtur **Energy Development Group Kosova** me kapacitet **6MW në lokacionin Kodra Hutit (Madanaj - Gjakovë) komuna e Gjakovës**. ANDAJ në pajtim me Nenin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr 07/2017), nëpërmjet kësaj **NJOFTON** palët e interesit se ka aplikuar në Zyrrën e Rregullatorit për Energji në Kosovë, për Licencim të aktivitetit të **prodhimit** të energjisë elektrike me kapacitet prej 6MW. Aplikacioni për licencim të aktivitetit të **prodhimit** të energjisë elektrike, me të gjitha dokumentet relevante, është shqyrtuar nga punonjës të Zyrrës së Rregullatorit për Energji dhe konsiderohet në fazën finale për vendimmarrje.

Pas licencimit nga Zyra e Rregullatorit për Energji, i licencuari mund të kryej aktivitetin e prodhimit të energjisë në Kosovë, në pajtim me dispozitat e licencës, Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Të gjithë palët e interesuara mund të kundërshtojnë dhënien e kësaj licence brenda **tetë (8) ditësh pune**, nga data e shpalljes së këtij njoftimi në gazetë (portal). Kundërshtimi/ankesa mund të bëhet në adresën: Zyra e Rregullatorit për Energji, Rr. “Bekim Fehmiu” (ndërtesa e Arting), Kati i II-të, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës; e-mail: hysnije.rexhaj@ero-ks.org; Tel.038247615/118.

Adresa: Gjakovë, fshati Madanaj, rruga. Qafa, p.n.

Energy Development Group, Madanaj, 50 000 Gjakovë. Telephone: +38345560001



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Edon Qaushi B.I nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit më numër identifikues: 811146069 të lëshuar nga ARBK.

- Krenare Kastrati shpall të pavlefshme dëftesën e klasës -IX- të SHFMU “Abdyl Frashëri”, Prizren.

- ARBNORA HALITI, shpall te pavlefshme diplomën e SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.

- LEUTRIM ZYMERI, shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës te SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.

- ERMIRA MURSELI, shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës te SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.

- SPASENA RADOSAVLJEVIC B.I, shpall të humbur certifikatën e biznesit me numër unik identifikues: 810698631.

- Endrit Cena nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.M. “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.


- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



Në mbështetje të Nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 15.06.2008, nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-011 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 30.05.2012, nenit 162.1.7 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 24.05.2018, nenit 27.1.8 të Statutit të N.P.L “Eko Natyra” Sh. A, të miratuar me datë 15.01.2024, nga Komisioni Komunal i Aksionarëve të Komunës së Skenderajt, nenin 41 pika 1.1.3, e Rregullores për Organizimin dhe Strukturimin e Brendshëm të NPL “Eko Natyra”, me nr protokolli 055/2025 e datës 16.06.2025, lidhur me vendimin me nr.166 /2025 të datës 24.07.2025 të marr nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L “Eko Natyra” Sh.A, Skënderaj, me datë 28.07.2025, shpall:

KONKURS PUBLIK I JASHTËM

I. Titulli: Zyrtar Kryesor Financiar

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës: Për një periudhë tre (3) vjeçare, me mundësi vazhdimi

Përgatitja profesionale: Përgatitje universitare, Fakulteti Ekonomik

Përvoja e punës: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale

I raporton: Bordit të Drejtorëve

Koeficienti i pagës: VI

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kujdeset për menaxhimin e llogarisë bankare të ndërmarrjes.
- Kryen transaksionet financiare të ndërmarrjes.
- Kontrollon pagesën e faturave.
- Bën kontrollin financiar të pasurisë dhe parave të gatshme.
- Do të menaxhojë, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e KE çështjet financiare të ndërmarrjes.
- Varësisht prej kufizimeve të vëna nga bordi i drejtorëve, do të ketë autoritetin e lidhjes të të gjitha kontratave financiare për ndërmarrjen.
- Të monitorojë llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesën e faturave dhe të gjitha blerjet;
- Të rishikojë shpenzimet e faturave të arritura dhe të sigurojë mjete për realizimin e tyre;
- Të përgatisë të dhënat e ndërmarrjes për auditim;
- Të bashkëpunojë me KE dhe zyrën e prokurimit të ndërmarrjes;
- Të menaxhojë thesarin e ndërmarrjes;
- Të vendosë dhe përgatitë buxhetin e ndërmarrjes, si dhe
- Çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar me akte normative të ndërmarrjes.
- Për punën e vet i raporton Bordit të drejtorëve të ndërmarrjes.

➤ **Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

➤ Kushtet e veçanta që duhet ti plotësojnë të gjithë kandidatët janë të parapara me nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-011 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

➤ **Aplikacionit duhet bashkangjitur:**

- Formulimi për aplikim i N.P.L “Eko Natyra” Sh. A (i cili merret në zyrën e arkivës të ndërmarrjes);
- Rezime për jetëshkrimin e kandidatit
- Letër Motivuese
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për kualifikimin Universitar (e skanuar)
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara)
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar)
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale plotësuese që e pengojnë në ushtrimin e kësaj pozite në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen)

➤ **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.**

- Intervista me gojë deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

➤ **Periudha e aplikimit të kandidatëve**

Konkursi mbetet i hapur njëzetë e një (21) ditë kalendarike nga dita e publikimit, dhe atë nga **28.07.2025** deri me datë **18.08.2025** në ora **16:00**.

➤ **Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët**

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L “Eko Natyra” Sh. A në qytetin e Skenderajt çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim:

eko.natyra2021@gmail.com

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet dhe dokumentacioni i pakompletuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë shpallje si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.

➤ **Sqarim**

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

➤ **Përfundim**

N.P.L “Eko Natyra” Sh. A, Skënderaj ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë personat të cilët i plotësojnë kushtet për të qenë Zyrtar Kryesor Financiar, pa dallim gjinije, përkatësie etnike, apo feje.

Albert Ismajli

**Kryesues i Bordit të Drejtorëve
të N.P.L "Eko Natyra" Sh. A,
Skënderaj**

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L